



Dep.	DPKI
Dep.	
Dep.	
Nr. lfaq	02
Broj stranica	
Nr. pages	
PRISHTINA	
Mr Prot	03-02-16323/16
Mr Prot	
Mr Prot	
Mr Prot	
Datum	17.11.2016
Datum	
Datum	
Datum	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK – 03-2972/16, për z. Ibrahim Arslan – Zëvendës i Avokatit të Popullit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2972/16, për z. Ibrahim Arslan – Zëvendës i Avokatit të Popullit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Arslan, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si zëvendës i Avokatit të Popullit dhe person i autorizuar në biznesin privat D.P.Z. “Picolo”.

Ai fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Arslan është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t'i bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Arslan, është bindur për kufizimin e funksionit menaxherial në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë, i njëjtë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Registrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 02/3674/16) me të cilën vërtetohet se ai ka emëruar një “person të besueshëm”, në funksionin e personit të autorizuar, ashtu siç e parasheh Ligji PKI. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Shaip Havollli

